



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Dr.str. 30		
Datë/Datum. 14.02.2018		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE Pranë komiteteve		



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e parë I-rë, e rregullt e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 29.01.2018, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha – Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Shaban Ademi, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Naser Graiçevci, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Arjana Zogiani, Mehdi Lahu, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Driton Ademi, Betim Ahmeti, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Qerim Gara, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Halil Qerimi - Nënkyetar i Komunës për Komunitete, Nuriye Fazliu - Drejtore e Administratës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Jakup Dumani - Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Mehmet Gërguri - Drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Të tjerë: Përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it dhe qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të datave: 13.12.2017 dhe 29.12.2017.
2. Propozim për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018.
3. Propozim për vazhdimin e lirimit nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018.
4. Propozim për lejimin e shpenzimit të mjeteve financiare nga 'kodi i bashkëfinancimit për subvencione në bujqësi për vitin 2018'.
5. Propozim për vazhdimin e 'Projektit të bashkëfinancimit me KARITAS Kosova për vitin 2018'.
6. Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete.
7. Propozim për plotësimin e Komitetit për Politikë e Financa.
8. Propozim për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2018.
9. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, konstatoi se ekziston kuorumi i mbledhjes, më pas lexoi pikat e rendit të ditës, ftoi anëtarët që të deklarohen rreth rendit të ditës dhe hapi diskutimin.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua të ndërlidhem me 'Propozimin për plotësimin e Komitetit për Politikë e Financa', ku vendimi ynë, i marrë më datë 29.12.2017, është anuluar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa nuk është mbajtur! Andaj, kërkoj që pikat që kanë të bëjnë me çështje financiare të hiqen nga rendi i ditës, pasi që nuk janë shqyrtuar paraprakisht në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, sipas rregullave ligjore. Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin rendit të ditës së propozuar për këtë mbledhje.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', gjashtë 'kundër' dhe gjashtë 'abstenime', gjithsej njëzet e shtatë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës, të datave: 13.12.2017 dhe 29.12.2017.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, për aprovim i kemi ekstraktet e procesverbaleve nga dy mbledhjet e kaluara: mbledhjes inauguruese të datës 13.12.2017 dhe mbledhjes së datës 29.12.2017. Hap diskutimin.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne, Grupi Parlamentar i LDK-së, nuk kemi vërejtje në ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhja inauguruese e datës 13.12.2017 dhe mbledhja e datës 29.12.2017, andaj propozojmë që këto dy ekstrakte të aprovohen.

Driton Ademi: E nderuara Kryesuese e Kuvendit të Komunës, unë kam mirëkuptim për takimin e parë - mbledhjen inauguruese të datës 13.12.2017 dhe pajtohem që të aprovohet ky ekstrakt i procesverbalit, por kështu siç është çështja tani në rendin e ditës, votimi i njëhershëm i dy ekstrakteve të procesverbaleve në paketë, nuk pajtohem, sepse në ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e dytë, e datës 29.12.2017, unë kam vërejtje substanciale në tre çështje: e para, në ekstrakt disa fjalë janë gabim, duhet të bëhet lektor- imi i materialeve dhe të ruhet 'kredibiliteti' personal i anëtarëve të Kuvendit, shkrimi të jetë i nivelit akademik dhe jo i nivelit të 'facebook-ut', e dyta, këtu pretendohet të bëhet një lloj votimi, unë nuk e pranoj saktësinë e votave, ka dilema se a kanë qenë katërmëdhjetë apo tremëdhjetë vota 'për' dhe e treta, kemi interpretim të vendimit, ku shkruhen detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Politikë e Financa, kjo duhet të hiqet nga ekstrakti, ne jemi anëtarë të rinj dhe duhet të përkrahemi, niveli i debatit duhet të jetë konstruktiv!

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje kam një kërkesë - që votimi për ekstraktet e procesverbaleve nga dy mbledhjet e kaluara të ndahet. Ne jemi për aprovimin e ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja inauguruese, e datës 13.12.2017 dhe kundër aprovimit të ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e datës 29.12.2017. Faktin tonë 'kundër' e dëshmon edhe anulimi i vendimit tonë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për arsye se mbledhja e thirrur e Komitetit për Politikë e Financa nuk është mbajtur.

Naser Graçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë të gjithëve iu dëshiroj një vit të mbarë, urime për objektin e ri të komunës! E para gjithmonë është e falur, por ne kërkojmë nga ish/Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, tani Nënkyetar i Komunës dhe Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, që të bëhet publikimi i audioincizimeve të mbledhjes në ueb-faqe.

Pas përfundimit të diskutimeve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe dhënies së vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 13.12.2017.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e katër anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 13.12.2017.

Në vazhdim të mbledhjes, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, me pranimin e kërkesës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për anulimin e vendimit nga mbledhja e kaluar, e qiti në votim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 29.12.2017.

U votua: me katërmëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe tre 'abstenime', gjithsej njëzet e katër anëtarë. Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e datës 29.12.2017.

Pika e dytë (2) - Propozim për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018'. Kemi paraparë që anëtarë të këtij Grupi Punues të jenë subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, meqë Plani i Punës shërben për Kuvendin e Komunës dhe Komitetet e Përhershme. Ftoj Grupin Parlamentar të LDK-së që ta japin propozimin e tyre për anëtarin e Grupit Punues.

Arjeta Jashari: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së, për anëtar të Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018, e propozoj z. Remzi Shala.

Naser Graiçevci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të PDK-së, për anëtarë të Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018, e propozoj zonj. Aida Alimi.

Mehdi Lahu: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtarë të Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018, e propozoi zonj. Eglantina Azemi.

Driton Ademi: Në rendin e ditës është edhe 'Propozimi për caktimin e anëtarëve për Grupin Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Kuvendit të Komunës për vitin 2018', ku propozohen përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike sikur në propozimin e dhënë. Plani Vjetor i Punës duhet të përfshijë aktivitetet e Kuvendit, por në propozim thuhet se: 'detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues është edhe Plani i Punës për Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete', të cilët nuk janë themeluar ende! Ata e bëjnë vetë planin e tyre të punës, andaj, mbështetur në këtë fakt, ne nuk kemi asnjë propozim për anëtar të Grupit Punues.

Betim Ahmeti: Përsëritës të pranishmit në mbledhje, edhe ne si subjekt politik i AAK-së, nuk e kemi asnjë propozim për anëtar të Grupit Punues.

Ali Ismaili: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Duhet të ndahet se çka votohet në realitet, siç e theksoi edhe përfaqësuesi i NISMËS. Si ta bëjmë ne Planin e Punës, vetëm për Kuvendin e Komunës apo edhe për Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete! Ne nuk kemi asnjë propozim për anëtar të Grupit Punues.

Driton Hasolli: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Ne si subjekt politik i AKR-së pajtohemi që të jemi pjesëmarrës në Grupin Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës për Kuvendin e Komunës për vitin 2018 dhe anëtar i këtij Grupi Punues do të jem edhe unë.

Bashkim Krasniqi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Edhe unë mendoj njëjtë, se Grupi Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018 nuk duhet të caktohet në këtë formë.

Pas sqarimeve dhe propozimeve të dhëna nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018', në përbërje prej shtatë anëtarëve, si vijon: Kryesuesja e Kuvendit të Komunës - Vjollca Konjusha, Zyrtari Ligjor për Kuvend dhe Komitete - Hasan Gjyrevci, Remzi Shala,

Aida Alimi, Eglantina Azemi, Driton Hasolli dhe Shefja e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim - Slaxhana Lazic.

U votua: me nëntëmbëdhjetë vota 'për', tre 'kundër' dhe katër 'abstenime', gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë. Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018', në përbërjen e cekur më lart dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018, në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, kryetare e grupit;
 - 1.2 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.3 Remzi Shala - Përfaqësues i LDK-së, anëtar;
 - 1.4 Aida Alimi - Përfaqësuese e PDK-së, anëtare;
 - 1.5 Eglantina Azemi - Përfaqësuese e LVV-së, anëtare;
 - 1.6 Driton Hasolli - Përfaqësues i AKR-së, anëtar;
 - 1.7 Slaxhana Lazic - Shefe e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtare.

Pika e tretë (3) - Propozim për vazhdimin e lirimit nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për vazhdimin e lirimit nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018'. Dua t'iu sqaroj se ky propozim duhet të aprovohet në parim dhe të dërgohet në diskutim publik. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Prapë e përsëris, duhet të ketë interpretim ligjor nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duhet të largohemi nga arroganca e numrave dhe t'i kthehemi procedurave të parapara me ligj dhe Rregulloren të Punës.

Nënkryetari i Komunës: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Ne këtu jemi duke punuar në bazë të ligjeve dhe Rregullores së Punës. Vendimet e Kuvendit të Komunës dërgohen për shqyrtimin e ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ato vendime të cilat nuk janë në harmoni me dispozitat e legjisllacionit në fuqi kthehen për rishqyrtim dhe plotësohen. Lirimi i bizneseve nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste, që zhvillojnë veprimtaritë e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës, duhet të vazhdojë edhe këtë vit. Ne duhet ta ndryshojmë 'Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale' dhe të mendojmë ndoshta për heqjen në tërësi të taksave komunale për bizneset, ashtu siç kanë vepruar komunat tjera, për t'iu dhënë mundësi zhvillimit të bizneseve dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës.

Driton Ademi: Unë dua të ndërlidhem me propozimin tuaj. Shkresa e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik i është drejtuar për shqyrtim Komitetit për Politikë e Financa që t'i jap rekomandimet e tij, pastaj propozimi në fjalë të shqyrtohet dhe aprovohet në Kuvendin e Komunës, kjo është procedura dhe ligjshmëria që duhet ndjekur.

Remzi Shala: Këtu qëllimi kryesor është vazhdimi i përkrahjes së bizneseve, krijimi i kushteve të favorshme që ato të zhvillohen dhe të rritet punësimi. 'Propozimin për vazhdimin e lirimit nga taksat komunale për bizneset që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018' Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah që të aprovohet në parim, sepse kjo iu është premtuar qytetarëve dhe bizneseve tona, e që nuk ka asnjë lidhje me zgjedhje, të cilat kanë përfunduar, sepse ne këtë po e bëjmë pas zgjedhjeve, sepse ne jemi që të gjitha bizneset të zhvillohen pa taksa komunale.

Mehdi Lahu: Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje kërkon që pikat e rendit të ditës: tre, katër, pesë dhe tetë, të mos shqyrtohen sot, të vazhdojmë me propozimet për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete.

Nënkryetari i Komunës: Ne e dimë që është e nevojshme që këto pika të shqyrtohen paraprakisht edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, i cili si trup i Kuvendit të Komunës ka të drejtë vetëm të jap rekomandime, Kuvendi i Komunës është organ vendimmarrës. Ne do t'i kemi edhe komitetet tjera, atë të Zhvillimit Ekonomik, Urbanizmit, Bujqësisë, e tjera, të cilët, po ashtu, mund të japin rekomandime për Kuvendin e Komunës. Por, për rendin e ditës, pavarësisht rekomandimeve të komiteteve të përhershme, apo komiteteve tjera, vendos Kryetari i Komunës dhe Kryesuesja e Kuvendit të Komunës. Ju vetë e dini si ndodh, së pari ne duhet ta plotësojmë Komitetin për Politikë e Financa dhe të vazhdohet puna, rendin e ditës sot e ka aprovuar shumica në Kuvendin e Komunës dhe secila pikë e rendit të ditës duhet të shqyrtohet, me marrjen apo jo të vendimit, këtë e vendos Kuvendi i Komunës.

Driton Ademi: Sigurisht që pajtohem me mendimin e parafolësit tim nga Lëvizja Vetëvendosje. Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës, Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës i parashohin rregullat e veprimit, ndodhi kjo që ndodhi në Kuvendin tonë, unë nuk pajtohem, pikë e veçantë duhet të jetë respektimi i procedurave të parapara.

Naser Graiçevci: Prapë për shqyrtim e kemi 'Propozimin për lirim të bizneseve nga taksat komunale për vitin 2018', për të cilin e kemi dhënë qëndrimin tonë edhe herën e kaluar. Bizneset duhet të lirohen nga taksat në tërësi, e jo të mbeten nën ethe! Komunitet tjera e kanë zgjidhur këtë çështje, sepse bizneset duhet të përkrahen. Vërejtjet e Auditimit të Përgjithshëm janë se për dymbëdhjetë vite janë grumbulluar 789 mijë euro obligime të bizneseve ndaj komunës, nëse nuk gaboj, çka ndodh, kjo vërejtje i është bërë Ekzekutivit të Komunës sepse taksat komunale nuk mbledhen.

Ali Ismaili: Në fillim dua të sqaroj se unë jam i saktë në fjalimet e mia, është mandati im i dytë në Kuvendin e Komunës, propozimet dhe çështjet e mira që shkojnë në dobi të qytetarëve i përkrah për aprovim. Në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa herën e kaluar kur ka qenë në shqyrtim 'Propozimi për lirim të bizneseve nga taksat komunale' kam thënë pse kjo nuk është bërë në vitin 2014, 2015, 2016, por po bëhet vetëm në vitin 2017, tani prapë i qëndroj atyre fjalëve, sepse ky është premtimi i pushtetit për lirim nga taksat komunale dhe e shihni kështu po ndodh! Atëherë në Komitetin për Politikë e Financa dhe në Kuvendin e Komunës kam kërkuar që bizneset të lirohen nga pagesa e taksave komunale për tre vite 2017, 2018 dhe 2019, Kryetari i Komunës, Burim Berisha thotë, mirë apo keq, jo vetëm një vit, kjo është e drejtë e juaja. Parafolësi im e theksoi se obligimet e bizneseve ndaj komunës janë mbi 800,000.00€, sa është kostoja e lirim të tyre për vitin 2018, a është një milion apo sa, ne nuk e dimë! Gjendja në shëndetësi kërkon që me çdo kusht të grumbullohen këto mjete financiare, as vitin e kaluar nuk kemi pasur raport, duhet ta dimë për çka ngremë dorën, të marrim sqarime!

Drejtori i ZHE-së: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Nga Nënkryetari i Komunës dhe anëtar i Kuvendit të Komunës, z. Naser Graiçevci, u tha se lirim nga taksat e biznesit është i rregulluar me ligje dhe rregullore. Ne jemi që të respektohet ligji, mirëpo komuna e ka të drejtën që të vendos apo jo taksa për bizneset. Si komunë jemi të shtyrë që ta bëjmë lirim të bizneseve nga taksat komunale, sepse këtë e kanë bërë komunitet përreth, duhet të jemi të barabartë me Prishtinën, Lipjanin, përndryshe bizneset lëvizin aty ku është më i favorshëm operimi i tyre. Jemi për përkrahjen e bizneseve të reja në fazën fillestare, duke i liruato nga taksat komunale, në mënyrë që të mundësohet zhvillimi ekonomik dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës. Nuk kemi ndonjë dobi të madhe financiare nga grumbullimi i taksave të biznesit, janë diku rreth 30,000.00€ deri në 40,000.00€ në vit, andaj kërkojmë që të hapen procedurat dhe 'Propozimi për lirim të bizneseve nga taksat komunale', të aprovohet në parim dhe të diskutohet për lirim të tyre, ndoshta jo vetëm për një vit, por në tërësi.

Ali Ismaili: Pa raporte zyrtare nuk po dimë asgjë, çfarë janë implikimet vjetore në buxhetin e komunës, a janë 50,000.00€, apo sa duhet ta kemi me shkrim! Ligji thotë kështu, nuk jeni në rregull, nuk ka argumente, sa janë shumatat e taksave të liruara nga vitet e kaluara, sa taksa grumbullohen nga certifikatat e lindjes, sa nga taksat tjera!

Nënkryetari i Komunës: Realisht, shuma për të cilën ne po flasim është rreth 150,000.00€, ne kemi filluar në mandatin e kaluar me lirin nga taksat e biznesit, sikur të gjitha komunat tjera, taksat tjera të përhershme për shërbime mbeten pjesë e Rregullores, për vitin 2017 e kemi shfuqizuar vetëm nenin 8 që i parasheh taksat e biznesit, njësoj ka vepruar edhe Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Lipjanit.

Betim Ahmeti: Nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës nuk u prezantua cili ishte drejtori që foli për pikën në fjalë, ne jemi anëtarë të rinj të Kuvendit të Komunës dhe duhet ta dimë cili është drejtori i drejtorisë përkatëse, në këtë rast i Zhvillimit Ekonomik!

Remzi Shala: Dua ta bëjë këtu një qartësim për anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili, u tha: 'fushatë', arsyeja është se këtu nuk kemi të bëjmë fare me fushatë, meqë lirimi po propozohet të bëhet pas fushatës, po ta lidhnim ne këtë me interesa partiake lirin do ta kishim bërë para fushatës zgjedhore. Ne po kërkojmë, që të lirohen nga taksat komunale të gjitha bizneset, nga Nënkryetari i Komunës u dhanë, edhe shumat e përafërta që grumbullohen nga këto taksa komunale.

Ali Ismaili: E nderuara Kryesuesja e Kuvendit të Komunës këtu po jepen sqarime 'kotrum' (kuturu)! Nënkryetari i Komunës ishte më i qartë, tha se shuma është rreth 150,000.00€, unë i kërkoja raportet zyrtare për vitet e kaluara, për vitin 2017 të thuhet se shuma ka qenë 50,000.00€ apo 200,000.00€! U tha se bizneset po ikin në Komunën e Prishtinës dhe komuna tjera, në fakt në të gjitha pikat e rendit të ditës që po i shqyrtojmë sot për mua janë të kundërligjshme.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim në parim dhe dërgimin e tij në diskutim publik 'Propozimin për vazhdimin e lirit nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018'.

U votua: me njëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe dy 'abstenime', gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi në parim për diskutim publik 'Propozimin për vazhdimin e lirit nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore për subjektet afariste në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të 'Propozimit për vazhdimin e lirit nga taksat për ushtrimin e aktiviteteve biznesore të subjekteve afariste në Komunën e Fushë-Kosovës, për vitin kalendarik 2018 dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik'.

Pika e katërt (4) - Propozim për lejimin e shpenzimit të mjeteve financiare nga 'kodi i bashkëfinancimit për subvencione në bujqësi për vitin 2018'.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e shpenzimit të mjeteve financiare nga kodi i bashkëfinancimit dhe participimi i qytetarëve për subvencione në bujqësi', ftoj Drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që të na jap sqarime.

Drejtori i BZHR-së: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, duke u mbështetur në kërkesat e qytetarëve, e kemi kalkuluar mënyrën e bashkëfinancimit, në shumë prej 254,000.00€, ku hyn edhe shuma prej 66,808.00€ dhe participimin e fermerëve në vitin 2018, në shumë prej 43,800.00€, shpenzimin e këtyre mjeteve financiare e kemi paraparë sipas specifikimit në propozim. Listën e përfituesve për vitet paraprake e keni në ueb-faqen e komunës.

Naser Graiçevci: E rëndësishme është se ndihmohen fermerët tanë. Ne si opozitë i kemi vërejtjet tona për kontrollin e këtyre subvencioneve, monitorimin e rezultateve në terren, në mënyrë që të mos përfitojnë të mira publike, familja, rrethi i pushtetit, sikur deri tani, sepse nuk kemi parë ndonjë kreativitet! Ekzekutivi i Komunës vazhdon me mënyrën e njëjtë, as kahen nuk e ndryshon fare,

serra, pula, gjedhe, motokultivatorë, mekanizëm bujqësor! Duhet ta dimë a është zgjeruar me këto subvencione kapaciteti i fermerëve, kemi një shkëputje në mes asaj që prodhohet dhe që shitet, sezoni për fermerët zgjat shumë pak, vetëm deri në vjeshtë. Ne si Grup Parlamentar i PDK-së kemi kërkuar që të ndërtohen depo për ruajtjen e produkteve bujqësore, jemi për forma të reja të subvencionimit të fermerëve, me këtë formë nuk pajtohemi sepse kjo nuk ndikon në ruajtjen e produktivitetit bujqësor, gjedhet janë shitur, motokultivatorët janë shitur për skrap!

Bashkim Krasniqi: Unë e përkrah propozimin në fjalë dhe do ta votoj, sepse askund sikur nga Drejtoria e Bujqësisë komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptas nuk kanë përfitur në numër, nuk është se janë zgjidhur problemet tona, por jemi përkrahur nga kjo drejtori e komunës.

Driton Ademi: Kryetari i Komunës, Burim Berisha ka kërkuar që ky propozim të përkrahet nga Komiteti për Politikë e Financa dhe pastaj të merret vendimi në Kuvendin e Komunës, ky është konstatim juaji! Në bujqësi përkrahen rastet sociale, unë nuk e pranoj participimin në bujqësi për vitin 2018, ne jemi duke punuar kundër Rregullores.

Betim Ahmeti: Në letër shkruan se ky propozim së pari duhet të shqyrtohet në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, i cili i propozon Kuvendit të Komunës që të merr vendim dhe të vazhdojë puna për subvencionimin e fermerëve.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është kundër procedurës së shqyrtimit të pikave të rendit të ditës pa u shqyrtuar ato në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa. Në parim ne e përkrahim 'Propozimin për subvencionimin e fermerëve në vitin 2018', por ndarja e subvencioneve duhet të plotësohet me transparencë në mënyrë që të sigurohet mirëqenia e jo mirëmbajtja e votuesve, nepotizmi, pa asnjë matje për ndikimin dhe efikasitetin e ndarjes së subvencioneve! Në vitet: 2014, 2015 dhe 2016 janë favorizuar personat e njëjtë nga dy herë, subvencionet janë ndarë në baza partiake dhe familjare, pa kriterë, makina mjelëse i është ndarë personit që nuk ka lopë, më e keqja është se ajo është shitur - është tjetërsuar! Përfituesit janë të njëjtë, qytetarët nuk kanë as si të ankohen, sepse nuk ekziston një data-bazë, regjistër i përfituesve, a ka mbikëqyrje, a janë bërë ndarjet drejt, si ka punuar komisioni, mirë apo keq, shoqëria civile nuk lejohet të marrë pjesë, ne jemi kundër ndarjes së subvencioneve në këtë mënyrë!

Remzi Shala: Diçka u tha nga anëtarë i Kuvendit të Komunës Bashkim Krasniqi, mirëpo suksese ka edhe në shëndetësi edhe në arsim. Në bujqësi janë ndihmuar fermerët e vegjël, pa dallime në strukturën e tyre fetare etnike apo partiake, sikurse unë, edhe Driton Ademi, edhe të tjerët, e dini se nuk ka pasur ndarje partiake, ata që kanë keqpërdorur ndonjë subvencion paditë i kanë në gjykata, i verifikojnë, është Komisioni Vlerësues. Unë personalisht jam që të vazhdohet me subvencionimin e bujqësisë, por të ketë një kontroll cilësor. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së e përkrahim 'Propozimin për subvencionimin e bujqësisë në vitin 2018, nga kodi bashkëfinancimit dhe participimi i fermerëve'.

Ali Ismaili: Është keq që anëtarët e rinj të Kuvendit të Komunës nuk e dinë që për ndarjen e subvencioneve në bujqësi ekziston Komisioni! Unë dhe Shaban Ademi kemi qenë në atë Komision, jam që Grupet Parlamentare ta formojnë një Komision. U tha nga anëtarë i Kuvendit të Komunës, z. Bashkim Krasniqi dhe u lavdërua puna në bujqësi, sepse janë ndarë dymbëdhjetë motokultivatorë për komunitetet, janë publikuar edhe në 'facebook'. Anëtarë tjetër, Naser Graiçevci, me të drejtë, e përmendi se duhet të ndryshohet diçka, të publikohen listat e përfituesve, raportet e punës janë e vetmja mënyrë ku ne mund të dimë diçka, sepse çdo vit po i ndajmë nga

200,000.00€! Ne kërkojmë që të ndryshohet kahja e ndarjes së subvencioneve në bujqësi, jo të vazhdohet kështu me ndarjen e serrave, motokultivatorëve, e tjera!

Mehdi Lahu: Ne e dimë se subvencionet në bujqësi ekzekutohen çdo vit, mirëpo shumë pak i njohim rezultatet! Kërkoj nga organet kompetente të komunës sonë që të na njoftojnë se a ka ngritje ekonomike dhe cili është efekti i madh apo i vogël, a është analizuar kjo punë nga ekspertët e bujqësisë. Transparenca nuk mjafton me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të gjitha partive politike në komision, e rëndësishme është a janë konsultuar ekspertët për mënyrën e shpërndarjes.

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje, por në mbledhjen tjetër, meqë nuk kemi sot pyetje dhe pyetje parlamentare - për Kryesuesen, a jeni ju mësuese apo Kryesuese!? Unë pajtohem që edhe këtë vit të vazhdohet kështu me ndarjen e subvencioneve, por vitin tjetër mënyra e ndarjes të ndryshohet, tani për tani përfitues janë ekonomitë familjare, të serrave, gjedheve apo motokultivatorëve, mirëpo kjo tani po e humb kuptimin! Ka informata se dikush e ka shitur gjedhin, dikush motokultivatorin, keqpërdoruesit duhet të evidentohen dhe të mos përkrahen në të ardhmen. Duhet të këtë transparencë në këtë punë. Unë nuk dua që nga Kryesuesi i Grupit Parlamentar të përmendet emri im dhe të thuhet se Grupi Parlamentar e përkrah propozimin në fjalë, unë do ta vlerësoj situatën dhe ka raste kur do ta ndajë mendimin tim nga grupi, kërkoj që të mos flitet në emrin tim.

Nënkryetari i Komunës: Ndarjen e subvencioneve e kemi planifikuar me buxhet, buxhetin e vitit 2018 e kemi aprovuar në mandatin e kaluar, ndarja e subvencioneve është e specifikuar për ta rritur transparencën, ekzekutivi i komunës dëshiron të informojë Kuvendin e Komunës për mënyrën e shpërndarjes, opozita është këtu për të korrigjuar. Dua t'i them z. Driton Ademi ka keqpërdorime, dilni me shkrim edhe neve na ndihmoni, kjo është puna e ekzekutivit, legjislativi, organet e pushtetit janë të ndara, janë edhe organet tjera për keqpërdoruesit. Është bërë shpërndarja e gjedheve, pulave, serrave e motokultivatorëve, janë ndihmuar ekonomitë familjare, varësisht prej nevojave të tyre, për keqpërdoruesit ekzistojnë paditë gjyqësore.

Betim Ahmeti: Nënkryetari tha se është punuar drejt, punën e mirë ne e përkrahim, a ka kritere për ndarjen e subvencioneve, sepse gjedhet dhe serrat i janë ndarë atyre që jetojnë në banesa!

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 297,800.00€, nga Kodi i bashkëfinancimit, subvencioneve dhe transfereve dhe participimi i fermerëve, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga buxheti i komunës dhe participimi i fermerëve për vitin 2018' si vijon:

U votua: me katërmëdhjetë vota 'për', dhjetë 'kundër' dhe një 'abstenim', gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 297,800.00€, nga 'Kodi i bashkëfinancimit, subvencioneve dhe transfereve dhe participimi i fermerëve, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga buxheti dhe participimi i fermerëve për vitin 2018' dhe mori:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 297,800.00€, nga Kodi i bashkëfinancimit, subvencioneve dhe transfereve dhe participimi i fermerëve, për realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë nga buxheti i komunës dhe participimi i fermerëve në vitin 2018

Pika e pestë (5) - Propozim për vazhdimin e 'Projektit të bashkëfinancimit me KARITAS Kosova për vitin 2018'.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për vazhdimin e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me KARITAS-in, për përkrahjen e sistemit shëndetësor, edukativ dhe shërbimeve publike, me kërkesën për rritjen e punësimit në arsim dhe shëndetësi. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Projekti me KARITAS-in ka mbijetuar mirë në Komunën e Fushë-Kosovës, ka mospërputhje ndërmjet propozimit të Ekzekutivit të Komunës dhe kërkesës së KARITAS-it për vazhdimin e projektit, faqja e parë me faqen e dytë nuk janë të harmonizuara, projekti nuk është i detajuar, mungojnë specifikat, marrëveshja është 'blanko', (e bardhë-e zbrazët) bëhet sikur në pazar! Drejtori i Shëndetësisë e ka propozimin në origjinal, KARITAS-i kërkesën në kopje, thuhet se do të përkrahen shërbimet sociale edukative administrative, mirëmbajtja, pastrimi, mjetet financiare janë të zotuarra më herët. Komuna ka qenë objekt i vlerësimit të parregullsive në këtë projekt edhe nga auditimi i jashtëm. Të harmonizohet teksti ose të hedhet poshtë kjo marrëveshje, nuk ka specifikim për mënyrën e zbatimit!

Mehdi Lahu: Ne, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, kërkojmë ta dimë çka përmban marrëveshja, këtë nuk po e shohim, të sillet njëherë marrëveshja dhe ne ta dimë çka duhet të votojmë!

Aida Alimi: Ne edhe në mandatin e kaluar e kemi cekur se duhet të na dorëzohet lista e përgatitjes profesionale të punëtorëve, sepse 90% e mjeteve financiare ndahen nga buxheti i komunës, ndërsa 10% nga KARITAS-i, të plotësohet me material shtesë propozimi në fjalë.

Remzi Shala: Marrëveshja me KARITAS-in është e domosdoshme të vazhdohet, sepse është në të mirë të popullatës. Ky projekt na ka ndihmuar shumë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe vizitave në terren, por besoj edhe shërbimeve tjera, si, shërbimeve publike, arsimi, e tjera. Me Ligjin e Shëndetësisë është e specifikuar që për trajtim janë vetëm shërbimet emergjente, totali i tyre është 10%, ne kemi shumë pacient edhe nga komunat tjera sepse jemi në qendër, andaj ky projekt na ka lehtësuar shumë punën. Projekti me KARITAS-in është i dedikuar për shëndetësinë, për ne të gjithë pacientët janë të barabartë, sepse projekti në fjalë i ka ndihmuar shumë me vizita në terren edhe komunitetet rom, ashkalinj dhe egjiptas. Kohëve të fundit e kemi kryer edhe procesin e imunizimit, projekti është mirë që të vazhdohet sepse e ndihmon jo vetëm shëndetësinë por edhe arsimin dhe shërbimet publike. Rritja e numrit të punëtorëve në shëndetësi nuk lejohet dhe si alternativë të vetme e kemi punësimin përmes projektit të bashkëfinancimit me KARITAS-in. Tani e kemi filluar një iniciativë që t'i trajtojmë vetëm banorët e Fushë-Kosovë, duke përjashtuar vetëm trajtimin e rasteve emergjente për të cilat na obligon ligji. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së e përkrahim vazhdimin e këtij projekti edhe për vitin 2018, me korrigjimet e tij, transparencë për listën e punëtorëve.

Bashkim Krasniqi: Ne duhet ta kemi të qartë çka po votojmë, të na shpjegohen çështjet, projekti ka funksionuar në praktikë dhe është përmirësuar gjendja sa i përket ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Gjendja e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptas është e vështirë, sepse shumica janë të varfër dhe përfitues në lista të rasteve sociale. Unë kërkoj që të aplikohet edhe punësimi nga këto komunitete, për ata persona që i plotësojnë kushtet. Është thënë më herët se nuk ka njerëz të arsimuar, tani nga radhët e komunitetit egjiptas kemi njerëz të shkolluar të cilët duhet të punësohen përmes këtij projekti dhe projekteve tjera.

Ali Ismaili: E nderuara kryesuese është obligim që të sqarohen çështjet, sepse deri tani ne për këtë projekt të bashkëfinancimit i kemi ndarë 800,000.00€ dhe nuk kemi asnjë raport nga Ekzekutivi i Komunës. Vitin e kaluar, të nderuar kolegë, unë kam bërë shumë zhurmë dhe e dini çka na është ofruar, janë vendosur 'fajllat' (dosjet) në dritare, ja këtu janë, shikoni kjo është tallje! Ne kërkojmë raport zyrtar për numrin e të punësuarve dhe pagat që i marrin ata, sepse ka dallime, personat për punë të njëjtë marrin paga të ndryshme. Është thënë se të dhënat i sjellim me raportin e punës së Kryetarit të Komunës, por është vazhduar njëjtë. Unë nuk e kam problem fare bashkëpunimin me KARITAS-in, UNDP-në, GIZ-in gjerman apo cilëndo organizatë qeveritare apo joqeveritare, por problemi është i brendshëm - në komunë, ne nuk kemi raporte për 250,000.00€ që i ndajmë! Njerëzit nga KARITAS-i i kam shokë të mirë, është tentuar të thuhet se unë po kundërshtoj, se jam Imam, kjo nuk ka asnjë lidhje, unë vetëm kërkoj raportim sipas ligjit për mjetet financiare të shpenzuara. Ne nuk kemi pasur raporte as për mjetet financiare të shpenzuara nga organizatat tjera joqeveritare, si p.sh.: Klubi i Futbollit, e tjera, kemi kërkuar që të zgjerohen kapacitetet tona në Drejtorinë e Shëndetësisë. U tha është bërë vaksinimi dhe është evituar një epidemi, punëtorëve shëndetësorë u ndahen mirënjohje, kjo nuk është mirë, ne si komunë, si shtet, duhet t'i forcojmë institucionet tona, jo të veprojmë në këtë mënyrë! Kjo mënyrë e parashtrimit të propozimeve për aprovim është bërë shabllon dhe metodë e punës për Ekzekutivin e Komunës!

Driton Ademi: Dua të ndërlidhem me diskutimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës, z. Remzi Shala, përkushtimi im dhe i NISMËS është që të përkrahen njerëzit në nevojë, por ne i kërkojmë detajet e projektit, ato nuk i kemi! Në përshkrim thuhet se janë të punësuar 17 në administratë, 21 në shërbime publike dhe 38 punësime në shëndetësi, projekti është i dedikuar për ngritjen e kapaciteteve shëndetësore dhe intervenime shëndetësore në terren. Këtë projekt 99 % e financon komuna dhe nuk kemi transparencë, ky është problem thelbësor, jo nevojat për shërbime më të mira.

Eglantina Azemi: Vazhdimin e këtij projekti për bashkëfinancim me KARITAS-in do ta votojmë kundër, sepse personat që punojnë aty marrin paga të ndryshme për kualifikimin e njëjtë, nuk kemi informata për konkursin, a ka qenë publik! Në mungesë të këtyre informacioneve ne jemi kundër.

Remzi Shala: Projekti me KARITAS-in është i dedikuar për shëndetësi, por ka krijuar mundësi edhe në fusha tjera - arsim dhe shërbime publike. Konkurs ka pasur, marrëveshja kontrollohet nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, ne jemi të hapur dhe kërkojmë transparencë, por jemi që të vazhdohet ky projekt sepse është i nevojshëm për shëndetësinë.

Driton Hasolli: Të nderuar kolegë, meqë para vetes ne nuk e kemi projekt-planin e detajuar, kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Nënkryetari i Komunës: Dua të jap disa sqarime, për Driton Ademin, Ali Ismailin dhe të tjerët. Rritja e numrit të punëtorëve në shëndetësi dhe arsim nuk po lejohet, andaj ne e kemi gjetur si alternativë këtë mundësi. Sigurisht që më së miri do të ishte punësimi i rregullt, por nuk ka zgjidhje tjetër, mbi 30 punëtorë të komunës punojnë në mirëmbajtjen e ambientit dhe kanë bërë një punë shumë të mirë, prandaj edhe për shëndetësinë duhet të vazhdohet ky projekt i bashkëfinancimit. Ne, vitin e kaluar, e kemi marrë një vendim për dhjetë norma të reja në arsim, por nuk po lejohet ekzekutimi i tij, kemi ndarë mjete për parashkollor - nuk lejohet ekzekutimi i tyre, kemi çdo vit rreth 600 nxënës të rinj, andaj jemi të interesuar ta vazhdojmë projektin me KARITAS-in për nevojat e arsimit shëndetësisë dhe shërbimeve publike - mirëmbajtjes dhe pastrimit, sepse nuk kemi zgjidhje tjetër. Duhet të mendojmë që gjatë këtij viti ta iniciojmë procedurën për themelimin

e një ndërmarrje lokale për mirëmbajtjen e ambientit dhe një për ngrohje, sepse ju e dini që jemi qytet në rritje të vazhdueshme, ku nevojat për shërbime janë të mëdha.

Driton Ademi: Mirë, e pranoni si marrëveshje nuk lejohet në këtë mënyrë, administrimi, mirëmbajtja dhe pastrimi janë fusha të gjëra, nuk lejohet kjo punë kështu 'blanko', (e bardhë-e zbrazët) mungon transparenca.

Nënkryetari i Komunës: Këto çështje janë paraparë më buxhetin e komunës, sepse nuk ka mundësi tjera.

Ali Ismaili: Po e përsëris, ne i kemi ndarë 800,000.00€, ndërsa nuk kemi raporte zyrtare për mjetet e shpenzuara, na brengos fakti që nuk jepen informata, vazhdoet njëjtë!

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për vazhdimin e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me KARITAS-in, për përkrahjen e sistemit shëndetësor, edukativ dhe shërbimeve publike, me kërkesën për rritjen e punësimit në arsim dhe shëndetësi për vitin 2018'.

U votua: me trembëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe katër 'abstenime', gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për vazhdimin e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit me KARITAS-in, për përkrahjen e sistemit shëndetësor, edukativ dhe shërbimeve publike, me kërkesën për rritjen e punësimit në arsim dhe shëndetësi për vitin 2018' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit Nr. 19, i datës 15.01.2018, për lejimin e mjeteve financiare, në shumë të përgjithshme prej 242,848.76€, për vazhdimin e realizimit të projektit 'Ngritja e përkujdesit social dhe shëndetësor në komunën e Fushë-Kosovës', në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me 'KARITAS Kosova' për vitin 2018'.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Komunitete', në përbërje prej shtatë anëtarëve, prej tyre katër duhet të jenë nga Kuvendi i Komunës dhe tre mund të jenë jashtë kuvendit të Komunës, komunitetet i kanë dhënë propozimet e tyre. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, Komiteti për Komunitete mund t'i këtë pesë deri në nëntë anëtarë, ku është e specifikuar që LDK-ja, PDK-ja dhe LVV-ja duhet ta kenë nga një anëtar, këtu ka paqartësi, sepse numri precizohet vetëm për Komitetin për Politikë e Financa.

Nënkryetari i Komunës: Numri i anëtarëve është i precizuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, bëhet sipas numrit të anëtarëve në Kuvendin e Komunës. Komiteti për Komunitete është për t'i mbrojtur interesat e komuniteteve joshumicë që jetojnë në territorin e Komunës. Këto janë rregullat, ne jemi 46% si subjekt politik në Kuvend dhe nuk parashihet t'i lëshojmë një partie politike me 2 apo 3 % vendin tonë, kjo nuk ka kuptim, këto janë rregullat, duhet ta kenë parasysh edhe plotësimin e kriterit gjinor.

Remzi Shala: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të LDK-së për anëtare të Komitetit për Komunitete e propozojmë zonj. Arjeta Jashari.

Aida Alimi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të PDK-së për anëtar të Komitetit për Komunitete e propozojmë z. Migjen Kolshi.

Mehdi Lahu: Pa sqarimin e ligjshmërisë dhe numrit të anëtarëve të Komiteti për Komunitete Lëvizja Vetëvendosje nuk e jep propozimin e saj.

Driton Ademi: Ne i bëjmë thirrje Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që të kontrollojë ligjshmërinë, sepse në këtë komitet mund të jenë edhe më shumë se shtatë anëtarë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e hodhi në votim 'Propozimin që Komiteti për Komunitete të përbëhet prej shtatë anëtarëve'.

U votua: me dymbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe dy 'abstenime', gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm, pas votimit Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave u pajtua që 'Komiteti për Komunitete të përbëhet prej shtatë anëtarëve'.

Mehdi Lahu: Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për anëtar të Komitetit për Komunitete e propozoj z. Durim Hajra.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon: Arjeta Jashari, Migjen Kolshi, Durim Hajra, Ljubisa Qirkoviq, Rexhep Hyseni, Xhemajl Hasani dhe Fehmi Gashi'.

U votua: me pesëmbëdhjetë vota 'për', tre 'kundër' dhe një 'abstenim', gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon: Arjeta Jashari, Migjen Kolshi, Durim Hajra, Ljubisa Qirkoviq, Rexhep Hyseni, Xhemajl Hasani dhe Fehmi Gashi' dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Arjeta Jashari - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.2 Migjen Kolshi - përfaqësues nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Durim Hajra - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4 Ljubisa Qirkoviq - përfaqësues i komunitetit serb nga Iniciativa Qytetare Serbe, anëtar;
 - 1.5 Rexhep Hyseni - përfaqësues nga komuniteti ashkali, anëtar;
 - 1.6 Xhemajl Hasani - përfaqësues nga komuniteti egjiptas, anëtar;
 - 1.7 Fehmi Gashi - përfaqësues nga komuniteti rom, anëtar.

Pika e shtatë (7) - Propozim për plotësimin e Komitetit për Politikë e Financa.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, 'Kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal', për rishqyrtimin e vendimit nga mbledhja e kaluar për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa, për plotësimin e Komitetit për Politikë e Financa me anëtarin e shtatë. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Unë kërkoj që të lexohet arsyeshëm Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2014, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, aty së pari kërkohet të arrihet proporcioni i përfaqësimit të partive politike, pastaj, nëse ka mundësi,

realizohet përçindja. Secili subjekt politik duhet të jetë i përfaqësuar me nga një anëtar, deri te numri shtatë.

Nënkryetari i Komunës: Sqaroj se, në Kuvendin e Komunës janë të përfaqësuar dhjetë subjekte politike dhe nuk mund të ketë gjithëpërfshirje, andaj shkohet sipas fuqisë politike.

Driton Ademi: Themelimi i komiteteve të përhershme nuk është i njëjtë me formulën e zgjedhjeve, në të duhet të përfshihen shtatë subjektet e para politike, kjo metodë është tendencë për ‘majorizim’ (mbivotim) dhe e eliminon përfshirjen e sa më shumë subjekteve politike në procesin e vendimmarrjes. Atëherë, unë pyes, si është futur përfaqësuesi i PDAK-së në Komitetin për Politikë e Financa, kur ju nuk keni një marrëveshje të formalizuar! Formula juaj 3 LDK-ja, PDK-ja 1, LVV dhe 1 PDAK-ja, nga del, PDAK-ja i ka 5% të votave, kjo kur pjesëtohet del 0.51, ndërsa ju kërkon nga subjektet tjera që të bashkohen për ta dhënë një anëtar ku pjesëtimi del 1.42%. askund nuk precizohet që komunitetet duhet të përfaqësohen në Komitetin për Politikë e Financa.

Ali Ismaili: Ka pasur kohë që për një muaj të kërkohet përgjigja nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal edhe ne sikur NISMA, AAK-ja e AKR-ja jemi pa përgjigje. Kujt i takon të propozoj, ne kemi mundur që përmes një marrëveshje politike të përfaqësohemi të gjithë në këto dy komitete të përhershme, sepse jemi dhjetë subjekte politike, mirëpo ju po e luani rolin e të fortit! Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim ‘Propozimin për anulimin e vendimit Nr. 03, i datës 05.01.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-kosovës në përbërje prej gjashtë anëtarëve’.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet e aprovoi ‘Propozimin për anulimin e vendimit Nr. 03, i datës 05.01.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-kosovës në përbërje prej gjashtë anëtarëve’ dhe mori:

V E N D I M

Anulohet vendimi Nr. 03, i datës 05.01.2018, për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-kosovës në përbërje prej gjashtë anëtarëve.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Sqaroj se anëtarët e komitetit të propozuar janë: Vjollca Konjusha, Remzi Shala, Mirvete Gërguri, Aida Alimi, Doruntina Jashari dhe Qerim Gara, mungon anëtar i shtatë, ftoj subjektet politike që t’i japin propozimet e tyre.

Arjeta Jashari: Unë e propozoj z Driton Hasollin për anëtar të Komitetit për politikë e Financa, meqë subjektet tjera politike nuk kanë dakordim për përfaqësimin me rotacion në këtë komitet.

Driton Hasolli: E nderuara, Kryesuese e Kuvendit të Komunës dhe të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka kundërshtuar vendimin tonë për themelimin e Komiteti për Politikë e Financa për arsye se në përbërjen e tij kanë qenë gjashtë anëtarë. Unë edhe si anëtar i Kuvendit të Komunës jam shumë komod dhe e vlerësoj besimin e dhënë nga qytetarët e komunës në zgjedhje për mua. Ne nuk kemi mundur të arrijmë një marrëveshje me subjektet politike për anëtarin e shtatë, ne nuk jemi që të bllokohet procesi për disa muaj apo një vit dhe meqë jam i propozuar për anëtar të Komitetit për Politikë e Financa dhe më jepet edhe ky nder, unë pajtohem dhe e pranoj vendimin që e merr Kuvendi i Komunës.

Driton Ademi: Kjo mënyrë e zgjedhjes është e keqe, ne nuk jemi për shtyrje, por rotacioni në përfaqësimin e Komitetit për Politikë e Financa nuk e njeh legjislacioni, as ligji, as udhëzimi administrativ, por ju vendosni kjo është qasja e juaj, ne jemi kundër themelimit të Komitetit për Politikë e Financa sipas ambicieve dhe pazareve të LDK-së!

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon: Vjollca Konjusha, Remzi Shala, Mirvete Gërguri, Aida Alimi, Doruntina Jashari, Qerim Gara dhe Driton Hasolli'.

U votua: me nëntëmbëdhjetë vota 'për', dy 'kundër' dhe dy 'abstenim', gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon: Vjollca Konjusha, Remzi Shala, Mirvete Gërguri, Aida Alimi, Doruntina Jashari, Qerim Gara dhe Driton Hasolli' dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej shtatë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Kryesuese e Komitetit;
 - 1.2 Remzi Shala - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Mirvete Gërguri - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.4 Aida Alimi - përfaqësuese nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.5 Doruntina Jashari - përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.6 Qerim Gara - përfaqësues nga Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës, anëtar;
 - 1.7 Driton Hasolli - përfaqësues nga Aleanca Kosova e Re, anëtar.

Pika e tetë (8) - Propozim për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2018.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2018', për qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, familjet e tyre në momentet më të pikëlluara të jetës së tyre, kur i humbin të afërmit e familjes, me realizimin dhe përkrahjen financiare ne u dalim në shërbim qytetarëve tonë. Hap diskutimin.

Aida Alimi: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së e përkrahim propozimin në fjalë dhe kërkojmë që kjo të bëhet për një periudhë afatmesme katërvjeçare.

Mehdi Lahu: Në parim, Lëvizja Vetëvendosje e përkrah mbulimin e shpenzimeve të varrimit, mirëpo kërkojmë ta dimë çka përmban kjo marrëveshje, përndryshe për ne është e pakuptim.

Pas sqarimeve dhe informimit se shuma që ndahet nga buxheti i komunës për një ceremoni të varrimit është 165€ për të gjitha bashkësitë fetare në Komunën e Fushë-Kosovës, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2018'.

U votua me pesëmbëdhjetë vota 'për', asnjë 'kundër' dhe shtatë 'abstenime', gjithsej njëzet e dy anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2018'. dhe mori:

VENDIM

Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për qytetarët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Fushë-Kosovës për vitin 2018, në shumë të mjeteve financiare nga buxheti i komunës prej 165€ për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.

Pika e nëntë (9) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 13:05 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevçi



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

